



Departamenti i i Promocionit të Shëndetit

Mbështetur nga:



dhe



Agjencia për Mbështetjen
e Shqërisë Civile

FAKTE NË LIDHJE ME MARIJUANËN PËR ADOLESHENTËT

Tiranë 2014

Për më shumë informacion dhe ndihmë:

**Adresa: Qendra Komunitare e Shendetit Mendor Nr 1;
Rr. Stavro Vinjau; Prapa ambasades amerikane. Tirane**

cel.	0692066359
e-mail	gencaxionp@albmail.com
website	www.aksionplus.net & NCSO-al.org



Aksion Plus 2014

Përmbajtja

I. Disa të dhëna që kërkojnë pak reflektim

- 1.1.Vartësia
- 1.2.Shkolla
- 1.3.Psikozat/Paniku

II. Dëshiron të dish më shumë për drogat? Ja disa fakte

- 2.1.Çfarë është marijuana dhe a ekzistojnë edhe lloje të tjera të saj?
- 2.2.Nga se është e përbërë marijuana?
- 2.3.Sa kohë qëndron marijuana në organizëm?
- 2.4.A është marijuana një “portë” hyrëse drejt përdorimit të drogave të tjera?
- 2.5.Çfarë ndodh nëse konsumoni marijuanë?
- 2.6.Në ç'mënyrë mund të ndikojë marijuana tek ju?
- 2.7.Çfarë shkakton marijuana në tru?
- 2.8.Në ç'mënyrë pirja e marijuanës prek mushkëritë?
- 2.9.A dëmtion marijuana zhvillimin e fetusit?
- 2.10.A zhvillon marijuana efektet e tërheqjes tek dikush që ndërpërt përdorimin e saj?
- 2.11.Po nëse dikush dëshiron të ndërpresë marijuanën?
- 2.12.A përdoret nganjëherë marijuana si medikament?

III. Burime të tjera informuese dhe institucionë që ofrojnë informim dhe trajtim

- 3.1. Instituti i Shëndetit Publik
- 3.2. Klinika Kombëtare e Toksikologjisë dhe Adiktologjisë
- 3.3. Aksion Plus (Qendër Komunitare për Trajtimin e Varësisë nga Drogat)

I. Disa të dhëna që kërkojnë pak reflektim

1.1. Varësia

Marijuana krijon varësi. Sigurisht që jo gjithkush që pi marijuanë krijon varësi. Janë disa faktorë që ndikojnë, si historia familjare (gjenet), mosha e hershme e fillimit të përdorimit, përdorimi edhe i drogave të tjera, marrëdhëniet me familjen dhe moshatarët, si dhe rezultatet e ulëta shkollore. Përdorimi në mënyrë të përsëritur i marijuanës mund të çojë drejt varësisë, ç'ka do të thotë se individët e kanë të vështirë që të kontrollojnë përdorimin e drogës, dhe shpesh nuk ndalojnë së përdoruri edhe nëse duan. Studimet tregojnë se 9% apo 1 në 11 nga ata që përdorin marijuanë krijojnë varësi. Kjo përqindje rritet deri në 17% apo 1 në 6 persona nëse përdorimi fillohet në adoleshencë, dhe 40 – 50 % nëse përdorimi i marijuanës është i përditshëm¹.

1.2. Shkolla

Përdorimi i marijuanës është i lidhur me rënie në rezultatet shkollore. Efektet negative të marijuanës të tillë si dëmtimi i vëmendjes, kujtesës dhe i të mësuarit mund të zgjasin me ditë dhe ndonjëherë me javë, sidomos kur përdorimi është i vazhdueshëm. Kush përdor marijuanë në mënyrë të vazhdueshme, mund të ketë rënie të performancës mendore në shumicën e kohës apo gjatë gjithë kohës. Në krahasim me moshatarët e tyre që nuk pinë, adoleshentët përdorues të marijuanës kanë tendencën që të marrin nota të ulëta dhe të braktisin shkollën e mesme². Kërkimet tregojnë se mund

1 NIDA: Teen's Brochure. Facts about marijuana.

2013

2 iben

të ulet KI (Koeficenza e Inteligjencës) nëse ajo përdoret gjatë fëmijërisë dhe adoleshencës. Gjithashtu, përdoruesit afatgjatë të marijuanës raportojnë një rënie të kënaqësisë për jetën, probleme me kujtesën dhe marrëdhëniet me të tjerët, gjendje shëndetësore dhe mendore të ulët, si dhe mundësi të pakta për një karrierë të suksesshme.

1.3.Psikozat/Paniku

Konsumimi i marijuanës në doza të larta mund të shkaktojë psikozë ose panik (çrregullime mendore) kurjeni në gjendje “high”. Disa njerëz përfjetojnë efekte akute psikotike (çrregullime të perceptimit dhe të mendimit, paranojë) ose kriza të panikut ndërsa janë nën influencën e marijuanës. Zakonisht këto efekte largohen kur substanca është ezauruar në organizëm. Shkencëtarët ende nuk janë në gjendje të thonë me siguri nëse përdorimi i marijuanës mund të shkaktojë çrregullime mendore. Por, përdorimi i saj mund të përkeqësojë simptomat psikotike kur individët vuajnë nga çrregullime mendore si skizofrenia, si dhe mund të ndikojë në përfjetimin për një kohë të gjatë të këtyre simptomave.

II. Dëshiron të dish më shumë për drogat? Ja disa fakte

2.1.Çfarë është marijuana dhe a ekzistojnë edhe lloje të tjera të saj?

Marijuana është një përzierje e gjetheve të thata të copëzuara të bimës në ngjyrë të gjelbër, kafe ose gri, farave dhe luleve të kërpit. Ajo emërtohet me emra të ndryshme si mall ose bar. Llojet e forta të kanabisit janë hashashi dhe

vaji i kanabisit.

2.2.Nga se është e përbërë marijuana?

Të gjitha llojet e marijuanës ndryshojnë trurin tonë. Marijuana përmban më shumë se 400 përbërës kimikë duke përfshirë edhe THC (delta-9-tetrahidrocannabinol) e cila është përbërësi kimik kryesore aktiv. Sasia e THC-së në marijuanë përcakton fuqinë e efektit në organizëm. Përbajtja e THC-së në marijuanë është rritur që nga viti 1980.

2.3.Sa kohë qëndron marijuana në organizëm?

THC në marijuanë përthihet në mënyrë të shpejtë nga indet dhjamore të organeve në trupin tonë. Në përgjithësi, testet standarde të urinës përcaktojnë “gjurmët” e THC edhe disa ditë pasi është përdorur. Tek përdoruesit e zakonshëm THC mund të gjendet ende e metabolizuar edhe disa javë pasi përdoruesi ka ndërprerë konsumimin.

2.4.A është marijuana një “portë” hyrëse drejt përdorimit të drogave të tjera?

Studimet afatgjata për problematikat që lidhen me drogën tregojnë se shumë pak nxënës të shkollave të mesme përdorin droga ilegale pa përdorur më parë marijuanë³. Gjithsesi, shumë të rinj që përdorin marijuanë nuk përdorin droga të tjera. Ja disa shpjegime teorike që tregojnë arsyet që çojnë drejt përdorimit të drogave të tjera:

- Ekspozimi ndaj marijuanës mund të prekë trurin, sidomos gjatë viteve të hershme kur ai është në zhvillim e

3 NIDA: Teen's Brochure. Facts about marijuana.
2013

sipër, deri në moshën 20 vjeçare. Efektet e marijuanës në tru gjatë kësaj periudhe kohore krijojnë “shteg” për tërheqje ndaj drogave të tjera. Eksperimentet e zhvilluara me kaviet në kushte laboratorike e mbështesin këtë mundësi; psh përdorimi i marijuanës në periudhën e adoleshencës mund të nxisë drejt opiateve si heroina dhe vikodina.

- Kush përdor marijuanë ka më shumë mundësi që të bjerë në kontakt me përdorues të tjerë, si dhe me persona që shesin edhe droga të tjera, duke rritur kështu rrezikshmërinë për t'u tunduar apo nxitur për të provuar dhe droga të tjera.
- Njerëzit që kanë një rrezikshmëri të lartë për të përdorur drogat, konsumojnë fillimisht marijuanë pasi është më e lehtë për t'u gjetur, njëlloj si duhani apo alkooli.

2.5. Çfarë ndodh nëse konsumoni marijuanë?

Disa njerëz nuk ndjejnë asgjë kur janë duke pirë marijuanë, të tjerë ndihen të relaksuar dhe euforik, dhe disa përfjetojnë ndjenja të papritura ankthi ose mendime paranojake (të ndikuara më së shumti nga disa lloje më të forta të marijuanës). Përdorimi i rregullt i marijuanës është i lidhur me depresionin, ankthin, mungesën e dëshirës dhe motivimit, ç’ka do të thotë një mungesë e interesit edhe për aktivitetet që më parë konsideroheshin argëtuese. Efektet e saj janë të

paparashikueshme, sidomos kur konsumohen edhe droga të tjera njëkohësisht.

Përdorimi i marijuanës në një kohë të shkurtër mund të shkaktojë:

- Problem me të nxënët dhe kujtesën
- Perceptime të shpërfytyruara (të dëgjimit, të të parit,

kohës dhe prekjes)

- Koordinim motorik i varfër
- Rritje e rrahjeve të zemrës

Marijuana ndikon tek çdo njeri në mënyrë të diferencuar bazuar në disa faktorë:

- Biologjik (gjenet e tij/saj)
- Niveli i THC-së në marijuanë, e cila përcakton rrezikshmërinë e saj.
- Eksperiencat e mëparshme me drogën
- Mënyrën e konsumimit të marijuanës (pirja si cigare kundrejt përtypjes)
- Dhe nëse janë të përfshira alkooli apo drogat e tjera.

2.6. Në ç'mënyrë mund të ndikojë marijuana tek ju?

Të nxënët: Ndikimi i marijuanës në vëmendje dhe kujtesë e bën të vështirë të mësuarit e informacioneve të reja dhe zgjidhjen e detyrave komplekse të cilat kërkojnë përqendrim dhe vëmendje.

Aktivitetet sportive: Marijuana ka impakt negativ në aftesitë për t'u orientuar në kohë dhe hapësirë, si dhe aftesitë lëvizëse dhe koordinuese të cilat mund të ndikojnë në performancën negative në aktivitetet sportive.

Gjyktimi: Marijuana si shumë droga të tjera mund ta dëmtojë gjykimin. Kjo mund të ndikojë në sjellje të rrezikshme të cilat mund të të ekspozojnë ndaj sëmundjeve seksualisht të transmetueshme si HIV, virus i cili shkakton sëmundjen AIDS.

2.7. Ç'farë shkakton marijuana në tru?

Marijuana vepron në pjesë të caktuara të trurit të cilat

përkufizohen si *receptorët kanabinoid*. Këta receptorë ndodhen në ato pjesë të trurit që janë përgjegjëse për kujtesën, të mësuarit, ndjenjën e urisë, koordinimin dhe kënaqësinë. Aktualisht dihet shumë pak në lidhje me efektet afatgjata në trurin e një përdoruesi të rregullt. Shkencëtarët përdorin teknikat imazherike të trurit për të studiuar trurin e një qenie humane, por ndodhen ende në fazat e para të kërkimeve në fushën e drogave. Ajo që dihet është se ka ndryshime midis trurit të një përdoruesi dhe një

jopërdoruesi të marijuanës, por nuk dihet ende domethënia e këtyre ndryshimeve apo kohëzgjatja e tyre, sidomos nëse dikush e ndërpret përdorimin e substancës. Kjo për arsy se është e vështirë të gjesh individë që përdorin vetëm marijuanë pa përdorur alkool, i cili ka gjithashtu impakt negativ në tru.

2.8. Në ç'mënyrë pirja e marijuanës prek mushkëritë?

Dikush që pi marijuanë në mënyrë të rregullt mund të ketë shumë nga problemet që lidhen me frymëmarjen dhe mushkërinë, të cilat hasen tek përdoruesit e cigares (nikotinës) të tillë si kollitje të shpeshta, rrezik për infeksione të rrugëve të frymëmarjes si pneumoni. Njëloj si pirja e duhanit, marijuana përmban një përzierje të gazrave dhe molekula toksike të cilat mund të dëmtojnë mushkëritë. Edhe pse ende nuk dihet me siguri nëse marijuana është shkaktare e kancerit në mushkëri, shumë njerëz që e pinë atë konsumojnë njëkohësisht edhe duhan, i cili shkakton kancer; përdorimi i marijuanës e bën shumë të vështirë ndërprerjen e duhanit.

2.9. A dëmton marijuana zhvillimin e fetusit?

Gratë shtatzëna këshillohen që të mos përdorin drogë pasi dëmtojnë fetusin. Studimet sugjerojnë se fëmijët e nënave që kanë përdorur marijuanë ndërkokë që kanë qenë shtatzëna, kanë ndryshime të trurit të cilat zhvillojnë probleme me aftësitë e zgjidhjes së problemeve, kujtesën dhe vëmendjen. Kërkime të mëtejshme duhet të zhvillohen për të kuptuar se cila substancë shkakton dëme dhe çfarë; psh gratë shtatzëna që përdorin marijuanë mund të përdorin njëkohësisht duhan apo alkool, të cilat gjithashtu dëmtojnë zhvillimin e fetusit.

2.10. A zhvillon marijuana efektet e tërheqjes tek dikush që ndërpert përdorimin e saj?

Po. Simptomat që zhvillohen nga ndërprerja e marijuanës janë të ngjashme me simptomat e tërheqjes nga nikotina, të tillë si irritueshmëri, probleme me gjumin, ankth dhe dëshirë e pakontrolluar për të marrë substancën edhe disa ditë pas ndërprerjes së saj.

2.11. Por nëse dikush dëshiron të ndërpresë marijuanën?

Kërkuesit janë duke testuar metoda të ndryshme për të ndihmuar përdoruesit e marijuanës që të mos konsumojnë drogë, duke përfshirë edhe disa medikamente. Programet aktuale të trajtimit fokusohet në këshillim dhe grupet e vetëndihmës. Gjithashtu janë edhe një sërë programe të përpiluara specifisht për të ndihmuar adoleshentët.

2.12. A përdoret nganjëherë marijuana si medikament?

Disa Shtete Amerikane kanë aprovuar një ligj i cili lejon përdorimin e marijuanës për qëllime mjekësore. Bima e marijuanës përmban përbërës të rëndësishëm për qëllime

mjekësore. Aktualisht, dy produkte në formë tablete që përmbajnë THC, përbërësin psikoaktiv të marijuanës, janë aprovuar për të trajtuar simptomat e të vjellave tek pacientët me kancer në kimioterapi, si dhe për të stimuluar urinë tek pacientët me AIDS. Gjithsesi, duhet pasur parasysh që marijuana pihet dhe tymi i saj kalon në mushkëri, përbërësit e saj mund të ndryshojnë nga njëra bimë tek tjetra, dhe rreziqet shëndetësore nga përdorimi tejkalojnë vlerën e saj për trajtim. Shkencëtarët janë duke vazhduar punën e tyre kërkimore për të gjetur metoda të sigurta për përdorimin e THC-ës dhe përbërësve të tjerë të marijuanës, të cilët mund të përdoren për qëllime mjekësore.

III. Burime të tjera informuese dhe institucionë që ofrojnë informim dhe trajtim

3.1. Instituti i Shëndetit Publik. Në këtë Institut, Pranë Departamentit të Edukimit dhe Promocionit të Shëndetit ndodhet Sektori i Shëndetit Mendor, i cili ofron trajnime dhe publikime të ndryshme mbi çështjet që kanë të bëjnë me shëndetin mendor. Duke qenë se abuzimi dhe varësia nga drogat lidhet drejtpërsëdrejti me mirëqenien tonë mendore, specialistët e sektorit të SHM, hartojnë materiale informuese në lidhje me drogat dhe efektin e tyre në shëndetin tonë.

Për më shumë informacione rreth materialeve të publikuara për drogat, mund t'i referoheni adresës [www.ishp.gov.al](http://ishp.gov.al) ose mund të na kontaktoni në adresën: [ishp.shendetimendor@gmail.com](mailto:shendetimendor@gmail.com)

3.2. Klinika Kombëtare e Toksikologjisë dhe Adiktologjisë. Kjo Qendër Shëndetësore Publike ofron

kryesisht trajtim në raste emergjente, për personat të cilët abuzojnë apo kanë krijuar varësi ndaj drogave. Gjithashtu, kjo klinikë shërben edhe si qendër kombëtare për rritjen profesionale të specializantëve në trajtimin e varësive të ndryshme.

Adresa: Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë.

3.3. Aksion Plus është një organizatë jofitimprurëse e cila ofron:

- Trajtim zëvendësues me metadon për individët që janë vartës nga heroina dhe opidet në përgjithësi.
- Këshillim psikologjik për parandalimin e përdorimit të drogave.
- Trajnime, workshope, publikim dhe shpërndarje të materialeve informuese.
- Edukim nëpër shkolla dhe qendra shëndetësore në lidhje me parandalimin dhe trajtimin.

Për më shumë informacion mund t’i referoheni adresës www.aksiyonplus.net

Adresa: Qendra Komunitare e Shëndetit Mendor Nr 1; Rr. Stavro Vinjau; Prapa ambasadës amerikane. Tirane cel. 0696178959

UNFPA Fondi i Kombeve të Bashkuara në Botë:

Promovon të drejtat e çdo gruaje, burri dhe fëmije për të gjuar një jetë të shëndetshme dhe me mundësi të barabarta, duke përdorur të dhënët mbi popullsinë në hartimin e politikave dhe programeve për uljen e varfërisë dhe për të bërë të mundur që çdo shtatzëni të jetë e dëshiruar, çdo lindje të jetë e sigurt, çdo i ri dhe e re të jetë i mbrojtur nga HIV/AIDS, dhe çdo vajzë dhe grua të trajtohet me dinjitet dhe respekt.

UNFPA ka filluar aktivitetin e saj në vitin 1969 dhe është burimi fiinaciar ndërkombëtar më i madh në botë për programet e popullsisë dhe të shëndetit riprodhues. Fondi që nga fillimi i punës së tij ka investuar afërsisht 1.6 miliardë dollarë në 150 vende në zhvillim apo tranzicion. Asistenca e UNFPA-së në Shqipëri ka filluar në vitin 1989 dhe kontributi finansiar deri më sot është rreth 8.5 milion dollarë

Vizioni i UNFPA-së përfshin:

- Akses universal në shërbimet e shëndetit riprodhues deri në 2015.
- Edukim parësor universal dhe ngushtim i hendekut gjinor në edukim deri në 2015.
- Ulje e vdekshmërisë amtare me 75 përqind deri në 2015.
- Ulje e vdekshmërisë foshnjore.
- Rritje e jetëgjatësisë.
- Ulje të niveleve të infeksionit të HIV.

Asistenca e UNFPA-së për Shqipërinë, 1989-2006

Asistenca zyrtare e UNFPA-së në Shqipëri filloi në vitin 1989 duke u përqendruar në mbështjetjen për sektorin shëndetësor dhe mori një rëndësi të veçantë pas Konferencës së Kajros për të ndërrmarrë hapat e duhura për zbatimin në shkallë kombëtare të Programit të ICPD.

Asistenca e UNFPA-së u përqendrua në këto fusha kryesore:

- Ngritja e shërbimeve të Shëndetit Riprodhues/Planifikimit

- Familjar në mbarë vendin.
- Ngritjen e kapacititeve institucionale të Ministrisë së Shëndetësisë në nivel qendror dhe lokal për të ofruar shërbime të shëndetit riprodhues.
- Sigurimin e mjeteve kontraceptive për sektorin publik, dhe mbështetjen e social marketingut, si dhe ngritjen dhe operimin e sistemit logistik të kontraceptivëve.
- Promovimi i koncepteve dhe standardeve të reja të Shëndetit Riprodhues të aprovuara në Konferencën e Kajros.
- Promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave, eliminimin e të gjitha llojeve të dhunës ndaj grave në kuadrin e zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Barazisë Gjinore dhe kundër Dhunës në Familje.

Për më shumë informacion dhe ndihmë:

**Adresa: Qendra Komunitare e Shendetit Mendor Nr 1;
Rr. Stavro Vinjau; Prapa ambasades amerikane. Tirane**

cel. 0692066359
e-mail gencaxionp@albmail.com
website www.aktionplus.net
& NCSO-al.org



Aksion Plus 2014